

**AKT - THEMELIMI**

Sot më datë 26/02/2024, duke u mbështetur në Legjislacionin Shqiptar në përgjithësi si edhe në veçanti në Ligjin Nr. 9901 të datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjin Nr. 9723 të datës 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Duke u mbështetur po ashtu edhe në këtë Akt-Themelimi të përpiluar dhe nënshkruar nga unë Ortaku i Vetëm, Z. Arian Cara themeloj këtë shoqëri me qëllim ushtrimin e veprimtarisë ekonomike sipas parashikimeve e përkufizimeve të bëra në këtë Akt-Themelimi ashtu si më poshtë vijon:

**Neni 1**

- i. Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari të ndryshme ekonomike.
- ii. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilës rregullohet nga Akt-Themelimi, Statuti i saj si dhe legjislacioni përkatës në fuqi.

**Neni 2**

Shoqëria themelohet nga:

- 1) Ortaku i saj i Vetëm, Z. Arian Cara, atësia Shyqyri, nënshtetas shqiptar i datëlindjes 18/06/1983, lindur Durrës(DR) – Shqipëri dhe banues në Durrës(DR), Lagje 12, Rruga Marta Burda, Nd. 8, H. 1, K. Postar 2004, në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me anë të dokumentit të identifikimit të llojit pasaportë me Nr. BD2139045 si dhe Nr. Personal ID I30618202I.

**Neni 3**

Shoqëria do të emërtohet 2.0



#### Neni 4

- i. Shoqëria do te kete selinë e saj në:  
**1) Durrës (DR), Lagje Nr. 4, Bulevardi Dyrrah, Hyrja Nr. 1, Nr pasurie 2/182+1-7, ZK8514, Kati 3-të.**
- ii. Selia e shoqërise mund edhe të transferohet.
- iii. Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar edhe filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, konform me ligjin shqiptar dhe/ose përkatës të huaj.

#### Neni 5

- i. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Afati mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakut/ëve.
- ii. Shoqëria 2.0 Sh.P.K. gëzon statusin e personit juridik Shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.

#### Neni 6

Shoqëria 2.0 Sh.P.K. do të ketë si objekt veprimtarie:

- a) konsulencë juridike;
- b) programim software, zhvillim web apo web-mobile dhe aplikacione core, UX design, zhvillim dhe analizë sistemesh Big Data, mirëmbajtje software dhe server, hostim, menaxhim dhe zhvillim aplikacionesh, konsulencë teknologjike dhe/ose shërbime të tjera në fushën e IT;
- c) marketing on-line;
- d) tregti automjetesh;
- e) qeradhënie automjetesh;
- f) fermë gjedhësh si dhe aktivitetet ndihmëse përkatëse;
- g) si edhe çdo gjë tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

### Neni 7

- i. Kapitali themeltar i shoqërisë është 5,000,000 (pesë million) lekë.
- ii. Ky kapital i takon ortakëve themelues si më poshtë:
  - 1) Z. Arian Cara – Ortak i Vetëm, i cili zotëron 1(një) kuotë, të barasvlefshme me 100% të kapitalit të shoqërisë.

### Neni 8

- iii. Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te ardhurave e perfitojne ortaket e saj.
- iv. Ortaku themelues do te perballoje humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne brenda sistemit bankar të Shtetit Shqiptar.
- v. Fitimet qe do te evidentohen pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakeve pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:
  - 1) fondi rezervë;
  - 2) shpërblimi që i takon ortakëve themelues.

### Neni 9

Shoqëria mund të hyjë ne veprimtari te përbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

### Neni 10

- i. Ortaku gëzon këto të drejta kryesore:
  - a) administrimin e veprimtarise ne perputhje me Akt-Themelin si dhe Statutin e saj;
  - b) pjesëmarjen ne rezultatet e çdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne Akt-Themelin si dhe Statutin e saj;

- c) të paraqesë e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve dhe organet e tjera te shoqerise;
- d) të heqë dorë nga shoqeria, heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise;
- e) të marrë pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaquesuesit te tij ose vete;
- f) të emeroje dhe te shkarkoje perfaquesuesit e tij, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

ii. Ortaku ka këto detyrime:

- a) të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare ne perputhje me Akt-Themelin dhe Statutin e shoqërisë;
- b) të marri pjesë ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata;
- c) t'i japi shoqërisë te dhenat e domosdoshme per perpunimin e çdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj;
- d) të kryejë detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.;
- e) nëse heq dore nga shoqeria ti njoftojne vendimin e tij asamblese 6 muaj perpara dhe duke çeduar te drejten e zgjedhjes;
- f) ti japi shoqërise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj;
- g) të kryejë shërbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

### Neni 11

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakut/ëve.

### Neni 12

- i. Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm.

- 
- ii. Në shoqërinë 2.0 Sh.P.K. administrator i shoqërisë do të jetë:
- 1) Z. Arian Cara, atësia Shyqyri, nënshtetas shqiptar i datëlindjes 18/06/1983, lindur Durrës(DR) – Shqipëri dhe banues në Durrës(DR), Lagje 12, Rruga Marta Burda, Nd. 8, H. 1, K. Postar 2004, në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me anë të dokumentit të identifikimit të llojit pasaportë me Nr. BD2139045 si dhe Nr. Personal ID I30618202I, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretë në të gjithë veprimtarinë e saj.
  - iii. Administratori emërohet per një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh financiare.
  - iv. Me miratimin e ortakeve mund te emerohen administratore dhe perfaqesues te tjere te shoqerise 2.0 Sh.P.K.
  - v. Administratori/ët emërohen per një kohezgjatje prej 5 (pesë) vitesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem.
  - vi. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.
  - vii. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit të shoqërisë apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

### Neni 13

- i. Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bere nga Ortaku/ët, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise.
- ii. Shoqëria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.
- iii. Asambleja e ortakut emeron likujdatorin, dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit.
- iv. Komisioni i Likujdimit perbehet nga një ose tre antare.
- v. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre.



- 
- vi. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

#### **Neni 14**

- i. Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakut/ëve.
- ii. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoquerine.
- iii. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.
- iv. Dispozita më të hollësishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne Statutin e saj.

#### **Neni 15**


Ky Akt-Themelimi hyn në fuqi menjëherë.

#### **Neni 16**

Ky Akt-Themelimi është hartuar në 3 ekzemplarë originalë, secili me fuqi të barabartë ligjore.

Ortaku/ët e shoqërisë 2.0 Sh.P.K. pasi lexuan, kuptuan dhe u dakortësuan me Akt-Themelimin (emër mbiemër, firmë):

- 1) Z. Arian Cara – Ortak i Vetëm i shoqërisë

A handwritten signature in blue ink, reading "ARIAN CARA", with a stylized "A" and "C". Below the name, there is a smaller, less distinct signature that appears to end in "ur".